



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË

SHUKALB  
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË**Maj 2017**

## Çfarë ka të Re në SHUKALB!

### SHUKALB dhe SHUKOS Organizojnë Takimin e Parë Rajonal të Benchmarking HUB



Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB) dhe Shoqata e Ujësjiellësve dhe Kanalizimit të Kosovës (SHUKOS) me mbështetjen e Programit të

Ujit për Danubin (DWP) dhe Bashkëpunimit Evropian për Benchmarking (EBC), janë angazhuar së bashku për zhvillimin e Programit të krahasimit të standardizuar/ Benchmarking HUB për Shqipërinë & Kosovën, për periudhën 2016-2018, që do të udhëhiqet nga SHUKOS. Qëllimi kryesor i programit është angazhimi i shoqërive UK në Shqipëri dhe Kosovë në përdorimin e Benchmarking jo vetëm për monitorimin e performancës, por mbi të gjitha si një mjet për përmirësimin e saj, nëpërmjet analizimit të treguesve të performancës ofruar nga platforma e Bashkëpunimit Evropian për Benchmarking (EBC). Gjithashtu, vetë shoqëritë do të kenë mundësi të krahasohen me shoqëri të ngjashme në rajon, dhe të mësojnë nga praktikatat më të mira të gjithësecilit. [lexo më shumë](#)

### Seminari i Trajnimit-të-Trajnerëve për Programin Efiçenca Komerciale

Në vitin 2016, Shoqata Ndërkombëtare e Basenit të Lumit Danub (IAWD), nën mbështetjen e Programit të Ujit të Danubit, hartoi një program strategjik afatgjatë për ngritjen e kapaciteteve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve



Kalendari i Përbashkët  
i Trajnimeve  
SHUKALB-SHUKOS  
2017



Kurset e Ardhshme  
të Trajnimit!

[Hyrje në Trajtimin e Ujit të Pijshëm - 18-19 Maj](#)

[Menaxhimi i Aseteve](#)

- 22 Maj

Bashkohuni me Ne!



në rajonin e Danubit nën emrin e markës, Partneriteti i Studimit të Danubit (D-LeaP). “Efiçenca Komerciale për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime” është një nga

programet e D-LeaP që Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB) dhe Shoqata e Ujësjiellësve dhe Kanalizimit të Kosovës (SHUKOS) kanë ndërmarrë sëbashku si HUB. Ky Program për ngritjen e kapaciteteve është një nga blloqet ndërtuese të programeve të trajnimit të D-LeaP, duke synuar një grup të përcaktuar procesesh brenda shoqërive ujësjiellës kanalizime që operojnë në Rajonin e Danubit.[lexo më shumë](#)

## Pasqyra e Eventeve

### Konferenca “Shqipëri – Hungari: Sjellim Së Bashku Profesionistët e Biznesit dhe Ujit”



Me datë 10 Prill, Ambasada Hungareze, Shoqata Hungareze e Ujësjiellësve (MaVíz), Ujësjiellësi i Budapestit, në bashkëpunim me Shoqatën Ujësjiellës Kanalizime të Shqipërisë

(SHUKALB), organizuan Konferencën me titull “Shqipëri – Hungari: Sjellim së Bashku Profesionistët e Biznesit dhe Ujit”, në Plaza Hotel, në Tiranë. Me një audiencë prej mbi 200 pjesëmarrësish, Konferenca e arriti objektivin e saj duke ofruar një platformë efektive për diskutim, forcimin e bashkëpunimit dhe transferimin e njohurive ndërmjet profesionistëve të biznesit dhe ujit të të dyja vendeve. Në konferencë morën pjesë përfaqësues nga institucione të ndryshme të të dy vendeve, si ministri, bashki, agjenci qeveritare, shoqëri ujësjiellës kanalizime, kompani private, banka, profesionistë të sektorit të ujit, si dhe biznesmenë të ndryshëm.[lexo më shumë](#)

## Programi i Trajnimit të SHUKALB, 2017



Na tregoni se cfarë mendoni!



## Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më efiçent, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

## SHUKALB Bashkëpunon me UK Shkodër në Dhënien e Kursit të Trajnimit



ë fundmi, gjatë dhënies së kursit të trajnimit, Kontrolli i Rrjedhjeve, më 21 prill, në Tiranë, SHUKALB zhvilloi një përfaqje inovative, duke kombinuar trajnimin teorik në

klasë me një demonstrim të drejtpërdrejtë të një kontrolli rrjedhjeje në praktikë. Pas ndjekjes së prezantimeve të plota të kursit, pjesëmarrësit ishin në gjendje të përjetonin, në praktikë, atë çka kishin mësuar, e cila i shtoi më tepër efektshmëri procesit të të mësuarit.[lexo më shumë](#)

## SHUKALB Zhvillon Kurset e Trajnimit “Kontrolli i Rrjedhjeve” dhe “Mbikqyrja”



Me datë 21 prill, SHUKALB dha kursin e trajnimit “Kontrolli i Rrjedhjeve”. Ky ishte kursi i dytë i trajnimit i zhvilluar si pjesë e Programit të Përbashkët të Trajnimit të

nisur nga SHUKALB dhe SHUKOS (Shoqata e Ujësullësve dhe Kanalizimit të Kosovës). Kursi i trajnimit u ndoq nga 13 pjesëmarrës nga shoqëritë ujësullës kanalizime Sarandë, Berat-Kuçovë, Fier, Tiranë dhe Shkodër. Pjesëmarrësit e tjerë vinin nga shoqëritë e Pejës dhe Gjakovës në Kosovë.[lexo më shumë](#)

## Kurset e Trajnimit që do të Zhvillohen në Maj



SHUKALB ka planifikuar dhënien e dy kurseve të trajnimit gjatë muajit Maj, “Hyrje në Trajtimin e Ujit të Pijshëm” dhe “Menaxhimi i Aseteve”. Kursi i trajnimit

“Hyrje në Trajtimin e Ujit të Pijshëm” do të zhvillohet më 18-19 maj, në Prishtinë. Ky kurs trajnimi do të shpjegojë të gjitha proceset e trajtimit të ujit dhe kontrollet bazë që duhet të kryhen. Këtu përfshihen, procesesi i ajrimit, sedimentimit, flokulimit, filtrimit, mënyrat e dezinfektimit të ujit si dhe kontrolli

i korrozionit, shijes dhe aromës.[lexo më shumë](#)

## Lajme nga Anëtarët tanë

### Durrësi Nënshkruan Marrëveshjen për Sigurimin e Shërbimeve të Furnizimit me Ujë për Zonat Rurale



Me datë 19 Prill, Bashkia Durrës dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit nënshkruan marrëveshjen për ndërtimin e tre ujësjellësve, të cilët priten të furnizojnë 24 orë me ujë për banorët në zonat

rurale të Durrësit. Investimet përfshijnë njësitë administrative të Katundit të Ri, Rrashbullit dhe zonës së Shkëmbit të Kavajës. Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes që u zhvillua në bashkinë Durrës kanë marrë pjesë kryebashkiaku, Z. Vangjush Dako, koordinatori i projektit të FSHZH, Z. Avni Dervishi, drejtori i Ujësjellës Kanalizime Durrës, Z. Spartak Kovaçi si dhe specialistë të sektorit.[lexo më shumë](#)

### UK Vlorë: Investime në Linjën Kryesore për të Përmirësuar Furnizimin me Ujë të Qytetarëve



Gjatë 2017, Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Vlorë (UK Vlorë) ka realizuar me sukses dy investime të rëndësishme për rikonstruksionin e linjave kryesore të furnizimit me ujë të qytetit të Vlorës,

përkatësisht në Lagjen “Lirim”, pranë Bashkisë dhe në Zonën e Ujit të Ftohtë (nga Akademia e Marinës deri te 7 pallatet). Këto janë zona shumë të vjetra të qytetit të Vlores të cilat për një kohë të gjatë kanë vuajtur nga mungesa e furnizimit me ujë në mënyrë të vazhdueshme. Investimet konsistojnë në zëvendësimin e tubave të vjetra dhe të amortizuara të gizës me tuba të reja polietileni me densitet të lartë (HDPE). Zëvendësimi i këtyre tubacioneve lindi si domosdoshmëri si për shkak të rikonstruksionit të disa rrugëve në qytet ashtu edhe për të përmirësuar situatën e furnizimit të

abonentëve. [lexo më shumë](#)

## Projekti i Qeverisë Gjermane do të Financojë Rikonstruksionin e Rrjetit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Librazhd dhe Prrrenjas



Kohët e fundit, Qeveria Shqiptare dhe Gjermane janë angazhuar sëbashku për të financuar projektin e rikonstruksionit të të gjithë rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për bashkitë Librazhd dhe Prrrenjas. Vlera totale e këtij investimi është 7 milionë Euro, ku 4 milionë

Euro do të financohen për Bashkinë Prrrenjas dhe 3 mln Euro për Librazhdin. Projekti përfshin gjithashtu ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujit të ndotur, që do të reduktojë ndotjen e lumit Shkumbin, do të mbrojë mjedisin, si dhe do të ketë një ndikim pozitiv në zhvillimin industrial dhe bujqësor në të dyja bashkitë.

---

## Trajnime dhe Mundësi Arsimimi

### Edicioni i 20-të i Shkollës Verore Ndërkombëtare mbi Rregulloren e Shërbimeve Publike | Torino, Itali | 4-15 shtator 2017



**Shkolla e Rregulloreve Lokale të Torinos** njofton se ka hapur zyrtarisht aplikimet për Edicionin e 20-të të **Shkollës Verore Ndërkombëtare mbi Rregulloren**

**e Shërbimeve Publike.** Shkolla Verore u drejtohet studentëve të vitit të fundit, studentëve të diplomuar dhe zyrtarëve të Administratës Publike (bashkive, prefektuarave, organeve rajonale) dhe agjencive rregullatore.

Pjesëmarrësit që do të përzgjidhen do të mund të përfitojnë nga tarifat shumë të ulëta të regjistrimit; **regjistrim falas** për vendet jo anëtare të OBEZH (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim) siç është Shqipëria dhe shteteve të anëtarësuar rishtaz në BE.

Regjistrimi përfshin **2 javë akomodim falas** në Torino.

Aplikimet janë të hapura. Afati: **5 qershor 2017**.

Për informacion të mëtejshëm dhe formën e aplikimit ndiqni linkun: [www.turinschool.eu/iss](http://www.turinschool.eu/iss)

---

## Të tjera

### Forumi Rajonal i Evropës dhe Azisë Qendrore (ECA), 23-25 Maj 2017, Dushanbe, Taxhikistan



[Oxfam](#) së bashku me Partneritetin Global të Bankës Botërore për Përgjegjshmëri Sociale do të organizojnë një Forum mbi përgjegjshmërinë ndaj ujit dhe shoqërisë në **Dushanbe më 23-25 maj 2017..**

Ky do të jetë një forum shumë i angazhues që synon të paktën të zgjerojë horizontet e pjesëmarrësve në programimin e përgjegjshmërisë sociale nëpërmjet procesit reflektues mbi "bllloqet ndërtuese" të përgjegjshmërisë sociale. Pjesëmarrësit do të zhyten në mësimin e përvojave të projekteve globale të përgjegjshmërisë sociale në kohë reale, si dhe do të mund të dialogojnë rreth çështjeve politike. Forumi i ECA do të ofrojë gjithashtu mundësi të shumta për networking dhe nxitjen e shkëmbimit midis pjesëmarrësve. Edhe pse tema kryesore do të jetë përgjegjshmëria ndaj ujit dhe shoqërisë, shembujt dhe modelet e nismave të përgjegjshmërisë sociale mund të përdoren edhe në sektorë të tjerë.

Për më shumë informacion ju lutem shikoni

linkun: <http://www.thegpsa.org/sa/forum/eca-regional-forum>

**Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë,**

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

**E-mail:** [info@shukalb.al](mailto:info@shukalb.al), **Web:** [www.shukalb.al](http://www.shukalb.al)